

Emri i Lëndës : Zhvillimi i Gjuhës dhe i Shkrim Leximit I (Profili Arsim Parashkollor)

Kodi	Tipi i lëndës	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
PRD 215	B	3	3	0.00	0.00	3.00	5
Lektori dhe orari i konsultimeve			Simon Rowe, MA				
Asistenti dhe orari i konsultimeve							
Gjuha e kursit			Albanian, English				
Niveli i lëndës			Bachelor				
Përshkrimi			Ky kurs është dezignuar për të pajisur me njohuri dhe aftësi studentët që do punojnë si profesionistë të arsimit parashkollor, për një mësimdhënie, sipas fushave, mbështetur në kurrikulën e arsimit parashkollor dhe mënyrën e implementimit të standardeve në praktikën e përditshme. Ky kurs është i vecantë pasi përmbajtja e tij akademike fokusohet në tema si teoritë e nxënies së gjuhës, bazat e gjuhës dhe shkrim-leximit, morfologjinë, sintaksën, semantikën, pragmatikën, strategjitë në zhvillimin e komunikimit, vështirësitë në të nxënë etj . Aftësitë më të spikatura intelektuale të përfuara gjatë kursit do të jenë të lidhura me zhvillimin e gjuhës dhe të folurit për të komunikuar, statet e zhvillimit të gjuhës, teoritë e nxënies së gjuhës, vlerësimi i aktiviteteve zhvillimore që nxisin zhvillimin gjuhësor tek nxënësit parashkollor. Aftësitë teknike dhe praktike të përfuara gjatë këtij kursi përfshijnë hatrimin e planit mësimor ditor, me qëllim mësimdhënien e kompetencave akademike dhe sociale. Aftësinë për të implementuar dhe rekomanduar strategji komunikimi ndihmëse dhe konstante me qëllim mbështetjen dhe avancimin a komunikimit tek nxënësit me dhe pa vështirësi në të nxënë. Aftësitë profesionale që studentët do të zhvillojnë gjatë kursit përfshijnë përshkrimin e metodave të ndryshme që përdoren për vlerësimin e aftësisë së gjuhës tek parashkollorët, krijimin e një mjedisi që ushqen shkrim leximin tek nxënësit dhe përzgjedhjen dhe përdorimin e duhur të librave për fëmijë. Metodot kryesore nga tënga të cilat do të përfitojnë studentët përfshijnë metodat interaktive të mësimdhënies, projekte, prezantime, burime on-line, lexime dhe punime të ndryshme.				
Objektivat			Studentët duhet të aftësohen : • të identifikojnë dhe shpjegojnë teoritë e ndryshme të përvetësimit të gjuhës dhe zhvillimit të saj • të shpjegojnë faktorët që ndikojnë në zhvillimin e gjuhës. • të identifikojnë elementet kryesore të programit të integruar të gjuhës • të demonstrojnë përzgjedhjen e metodave të përdorura në zhvillimin e mësimdhënies për çdo element. • të vlerësojnë teknikat e shumta të zhvillimit të aftësisë së të dëgjuarit në gjuhë që nxisin dhe zhvillojnë gjuhën e folur. • të identifikojnë kriteret për përzgjedhjen e një literature cilësore për fëmijët dhe të shqyrtojnë metodat e ndryshme të përdorimit të kësaj literature për shtimin e aftësive komunikuese. • të krahasojnë dhe të bëjnë dallimin e qasjeve të ndryshme ndaj zhvillimit të shkrim këndimit tek fëmijët. • të identifikojnë burime për mësimdhënien e aftësive komunikuese. • shpjegojnë përmbajtjen e çdo standardi dhe të përshkruajnë mënyrat e mësimdhënies për fëmijët në klasat e parashkollorit. • të hatojnë plan ditor dhe plan kapitujsh ku të integrojnë mësimdhënien akademike dhe aftësitë sociale. • të zhvillojnë stategji për nxitjen e nxënies së gjuhës, nëpërmjet përdorimit të strategjive formale dhe joformale të mësimdhënies. • të diskutojnë dhe të krahasojnë mbi teoritë e zhvillimit të gjuhës dhe ndërlikimet në zbatim. • të diskutojnë karakteristikat e zhvillimit specifik të gjuhës për fëmijët për fëmijët që flasin dy gjuhë. • të diskutojnë mbi kërkimet shkencore që lidhen me njohjen dhe zhvillimin e gjuhës. • të vlerësojnë përdorimin e gjuhës së nxënësve në klasë. • të përshkruajnë karakteristikat për një mjedis optimal të zhvillimit të gjuhës. • të përshkruajnë kushtet e vonës në të folur dhe crregullimeve. • të diskutojnë mbi strategjitë e zhvillimit të gjuhës tek fëmijët me diversitet linguistik. • të demonstrojnë raportin që ekziston ndërmjet kulturës, gjuhës dhe gjuhës së përdorur në shtëpi. • të pranojnë, respektojnë dhe mbështesin zhvillimin gjuhësor të të gjithë fëmijëve. • të vlerësojnë dhe demonstrojnë përdorimin e duhur të teknologjisë për zhvillimin gjuhësor të fëmijëve.				
Programi i Lëndës							

Java	Tema
1	Hyrje. Teoritë kryesore të nxënies së gjuhës. Teoritë e zhvillimit të gjuhës.
2	Kërkimet më të fundit lidhur me nxënien dhe zhvillimin e gjuhës. Kompetencat kyçe në të nxëniet e gjuhës.
3	Bazat e gjuhës. Kompetencat kyçe në nxënien e gjuhës.
4	Kompetenca e të dëgjuarit dhe të folurit.
5	Fjalori. Strategji për të nxitur komunikimin tek parashkollorët dhe zhvilluar aftësinë për të lexuar.
6	Gramatika. Kurrikulat e gjuhës dhe shkrim leximit të parashkollorit në Shqipëri. Procesi i planifikimit të kurrikulave.
7	Bazat e shkrim leximit të gjuhës. Mësimdhënia e të lexuarit tek prashkollorët. Zhvillimi i mendimit kritik tek fëmijët.
8	Provim Gjysmëfinal
9	Koncepti mbi germat. Të ndajmë librat me bashkëmoshatarët. Si të zgjedhim librat e duhur?
10	Përvetësimi fonologjik. Gjuha receptive dhe ajo ekspresive.
11	Njohja me alfabetin, germat dhe fjalët. Zhvillimi i shkrim këndimit bazuar mbi të folurin.
12	Njohja dhe analiza e teksteve specifike sipas moshës. Familja dhe zhvillimi i arsimit. Programet me në fokus fëmijët, prindërit dhe mësuesit.
13	Ndryshimet dhe çrregullimet gjuhësore. Vështirësitë në të nxënët ndërveprues. Disleksia. Disgrafia. Diskalkula.
14	Interesi dhe reagimi ndaj librit. Përdorimi i qasjeve, strategjive dhe teknikave për nxitjen e zhvillimit të gjuhës dhe shkrim leximit. Metoda dhe teknika bashkëkohore në mësimdhënie.
15	Strategjitë e të shkruarit. Mësimdhënia e "të shkruarit" tek parashkollorët. Fëmijët me nevojë të veçanta arsimore. Hartimi i planeve individuale edukative (PEI).
16	Provim Final
Parakushtet	
Literatura	California preschool curriculum framework. California Department of Education. Sacramenro 2010.
Referenca të tjera	- School for all, Save the children, www.scalbania.org - A World to discover. Save the children, MoES
Punë laborator	
Përdorimi i komp.	
Të tjera	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Kupton zhvillimin e gjuhës së zotëruar tek fëmijët dhe di si të ofrojë aktivitete në funksion të zhvillimit të saj dhe plotësimin e të nxëniet në fusha të tjera.
2	Kupton zhvillimin e gjuhës së shprehur/ekspresive tek fëmijët dhe di si të krijojë një mjedis në klasë që inkurajon fëmijët të përdorin gjuhën e folur për të shprehur nevojat, ndjenjat dhe idetë.
3	Kupton proceset e lidhura me zhvillimin e shkrim këndimit dhe krijon një kulturë pune që nxit prirjen drejt shkrim këndimit dhe zhvillimit të tij.
4	Kupton raportet që ekzistojnë ndërmjet fushave të zhvillimit, njeh aftësitë dhe konceptet që mund të aplikohen përgjatë kurrikulës dhe e përdorin këtë njohuri për të nxitur të menduarin e fëmijëve dhe aftësinë e tyre për të kuptuar botën.
5	Njeh dhe kupton se si faktorët e vecantë, mund të ndikojnë tek nxënësit në një ose më shumë fusha zhvillimore dhe ofron përvoja dhe krijon mjedise që u përgjigjen nevojave individuale të të gjithë fëmijëve.

6	Kupton dhe aplikon një sërë strategjish vlerësuese për monitorimin e përparimit të fëmijëve në arritjen e rezultatit dhe planifikon aktivitete në të gjitha fushat.
7	Përdor saktë strategjitë e punës në grup dhe krijon atmosferë që nxit të mësuarin.
8	Shfrytëzon llojet e ndryshme të materialeve dhe burimeve, duke përfshirë teknologjinë e fundit, që mund të përdoren me nxënësit e parashkollorit dhe të mbështesin procesin e mësimnxënies në të gjitha fushat.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës

Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja
Gjysmë finale	1	35
Kuize	0	0
Projekte	2	20
Projekte semestrale	0	0
Punë laborator	0	0
Pjesëmarrja në mësim	1	10
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final		65
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final		35
Total		100

Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)

Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	2	7	14
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	15	15
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			129
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5,16
ECTS			5